

Njoftim

Sot, më datë **07.06.2023**, ora **08:45**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Manjola Xhaxho (Relatore);**
- 2. Blerona Hasa (Anëtare);**
- 3. Sokol Ibi (Anëtar);**
- 4. Edlira Petri (Anëtare);**
- 5. Alma Kolgjoka (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.26 Regj.Themeltar, Datë 02.06.2023 Regjistrimi, me:

Paditësa: - Lefter Maliqi, kandidat për kryetar bashkie në Bashkinë Kuçovë,
përfaqësuar nga Avokatët Arben Llangozi dhe Orgesa Serani.
- Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga Altin Kaziaj.

Të paditur: - Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, pranë Komisionit Qendror
Zgjedhor.
- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve pranë Komisionit Qendror.

Person i interesuar: “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga Av. Maringlen Legisi.

Objekti: Shfuqizimin e pikës 2 të Vendimit nr.136, datë 24.05.2023, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) duke vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për gjykim pranë KAS.

Baza ligjore: Neni 124 e vijues i Kodit Zgjedhor, neni 4, 13, 14, 23, 24, 90, 109, 116 i Kodit të Procedurave Administrative.

me Vendimin Nr. 26, datë 07.06.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, unanimisht,

VENDOSI

1. Pranimin e pjesshëm të padisë.
2. Shfuqizimin e pikës 2 të Vendimit nr.136, datë 24.05.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.
3. Detyrimin e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve të bëjë pjese të shqyrtimit, kërkimet e rrëzuara për shkak të mungesës së kompetencës të kërkesës ankimore

nr.74, datë 22.05.2023, të ankuesit Lefter Maliqi, në kuadër të shkaqeve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve.

4. Pushimin e gjykimit të pjesës tjetër të padisë.
5. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
6. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë më datë 07.06.2023.

Tiranë, më 07.06.2023.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë